



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:264676

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05929425

AC-I-23-0175

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

F B - i përfaqësuar nga Avokati B I, Prishtinë.

Kundër:

E paditura

NSH. "Prishtina" (në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-16-0404, të datës 16 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 11 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-16-0404, i datës 16 shkurt 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 19 korrik 2013, paditësi dorëzoi në DHPGJS-së një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN034-0013 të datës 25 qershor 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën e pa specifikuar nga NSH Prishtina (në likuidim), ishte refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme në mbështetje të kërkesës së tij. Ai vetëm ka përfshire një Kontratë të punës nga 1977, e cila ka qenë kontratë për punë sezonale dhe ka skaduar më 1977.

Paditësi ndër të tjera ka theksuar se pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave dhe se Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe të njëjtën e ka refuzuar mbi bazën e lëshimit të afatit prej tri viteve duke u bazuar në Ligjin për Punën e Bashkuar. Ligji për Punën Bashkuar. Ligji për Punën e Bashkuar nuk është ligj në fuqi ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjen, ligji në fjalë ka pushuar se vepruari. Ka shtuar se arsyeja përse nuk i kanë parashtruar kërkesat më herët është fakti se pala e paditur ju ka thënë se kërkesat kreditore do të shqyrtohen në procedurat e likuidimit. Kësaj padie paditësi i ka bashkangjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave, kopjen e Librezës së punës dhe një autorizim për përfaqësim.

Me 03 dhjetor 2013, gjyqtari i çështjes kishte leshur një urdhër ku ndër të tjera kishte kërkuar edhe dorëzimin e provave në mbështetje të pretendimeve të tija të paraqitura me ankesë.

Me 20 janar 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore materiale. AKP-ja pohon në mbrojtjen e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se NSH Prishtina (në likuidim) ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 30 maj 2011. Pala paditëse ka parashtruar kërkesë i cili ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore 2001-2006. Autoriteti i Likuidimit i ka dërguar palës paditëse kërkesë për dëshmi shtesë dhe se në përgjigjen e dhënë nga pala e paditur nuk ka dërguar ndonjë dokument mbështetës, rrjedhimisht me vendimin me numër

PRN034-0013, kërkesa e palës paditëse është refuzuar. Më tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se pretendimet e dhëna nga pala paditëse kërkesë për dëshmi shtesë dhe se në përgjigjen e dhënë nga pala e paditur nuk ka dërguar nuk ka dërguar ndonjë dokument mbështetës, rrjedhimisht kërkesa e palës paditëse është refuzuar. ka shtuar se objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridike kontestimorë është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit respektivisht se procedura e likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin me nr.04/L034 dhe se parashtruesi i padisë nuk ka treguar se cila dispozitë ligjore nuk është respektuar nga na e autoritetit të Likuidimit, në procedurë të likuidimit. Më tutje ka theksuar se kërkesa e parashtruesit të padisë është e parashkruar ngase parashtruesi i saj është dashur që t'i drejtohet gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent brenda periudhës prej tri viteve nga momenti kur ndërmarrja nuk i ka kryer pagesat. Meqenëse parashtruesi pretendon në paga të vitit 2006, konform dispozitave ligjore të cituara kërkesa e tij është e parashkruar. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzojë si të pa pranueshme ose të pa bazuar dhe ta vërtetojë vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me 10 shkurt 2014, paditësi ka parashtruar përgjigje ndaj mbrojtje se AKP, duke theksuar se ankesa e tij duhet të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AL dhe mbrojtja e AKP-së nuk kanë bazë valide.

Me 5 prill 2014, e paditura AKP ka pashtuar një kundërpërgjigje ndaja përgjigjes se paditësit, duke konfirmuar pohimet edhe qëndrimin e AL dhe mbrojtjes se saj si te drejta dhe të bazuara ne ligj ndërsa ka propozuara që ankesa e paditësit te refuzohet si e pabazuar.

Me 18 qershor 2014, Kolegji Specializuar i DHPGJS, me aktgjykimin C-IV-13-1331 e ka refuzuara si te pabazuara kërkesën e paditësit në mungesë të provave dhe ka vërtetuar vendimin e AL- si te drejtë edhe të bazuara.

Kundër këtij aktgjykimi pala paditëse kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit te DHPGJS.

Me Aktvendimin AC-I-14-0207 të dt. 14 dhjetor 2016, Kolegji i Apelit , e kishte prishur aktgjykimin C-IV-13-1331 dhe çështjen e kishte kthyer ne rigjykim ne kolegjin përkatës.

Me 04 prill 2019 dhe 10 janar 2023, Shkalla e pare e DHPGJS , ashtu siç e kishte udhëzuara Kolegji i Apelit kishte kërkuar nga paditësi që të precizoj kërkesën e tij dhe të dorëzoj prova në mbështetjeje te kërkesës se tij duke specifikuar muajt dhe vitet përkatëse si dhe shumen e kërkuar.

Me 30 janar 2023, paditësi dorëzoj një përgjigje ndaj urdhrit duke theksuar se paditësi kishte punuar 25 vite në NSH dhe se ndërprerja e marrëdhënies se punës është pasoj e likuidimit të NSh-së. Po ashtu ka theksor ase paditësi kishte një page mujore prej 250 ne muaj duke filluara nga datat 02 shtatori 2002. Ka theksuar se librezja e punës është mbyllur si rezultat i likuidimit me dt. 27 qershor 2006 dhe gjithashtu AKM i ka droguar një letër paditësit se punësimi i tij ka përfunduar si rezultat i shitjes se asetëve . I ka propozuara gjykatës aprovimin e shumes prej 16,500.00 euro per 66 muaj nga 250 euro si dhe kamatën. Ka kërkuar edhe shpenzimet e përfaqësimit nga avokati. Si dëshmi ka bashkangjitur Librezën e punës, kontratën e punës, njoftimin e AKM-së per shkëputjen e punësimit dt. 27 qershor 2006, si dhe listën përfundimtar te 20 %.

Me 16 shkurt 2023 Shkalla e pare e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-16-0404, ka refuzuara ankesën e paditësit si ta pabazuar dhe ka vërtetëuar vendimin e AL si te drejte dhe të bazuar në Ligj. Në arsyetim të aktgjykimit thuhet se pala paditëse ka pretenduar në borxh- në emër të pagave të pa paguar që i referohet periudhës kohore 2001-2006, në anën tjetër pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë me pretendimin se borxhi i pretenduar është i parashkruar. Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe parashtrimet e palëve në procedurë dhe ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës ka punuar deri në vitin 2006, ndërsa kërkesën për kompensimin e pagave të pretenduar pranë Autoritetit të Likuidimit e ka parashtruar më datën 04.08.2011, që do të thotë se është parashtruar pas kalimit të aftit prej tri viteve. Andaj në kuptim të nenit 376 paragrafi i të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se "kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për demin

dhe për personin që e ka bërë dëmin”, gjykata ka ardhur në përfundimin se padia e parashtruar nga pala paditëse është e pa bazuar.

Me 23 mars 2023, paditësi/ankuesi e dorëzoi në DHPGJS, një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së ,C-IV-16-0404, të datës 16 shkurt 2023, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet Aktgjykimi i ankimuar, duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të pagave të pa paguar, t’i kompensojë paditësit për periudhën 01.01.2001 deri më datë 27 qershor 2006, për gjithsejtë shumën prej 16,330.00 euro me kamatë ligjore dhe të detyrohet e paditura që ta bëjë kompensimin e shpenzimeve përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit, ankues ka theksuar se më 16 janar 2023, gjyqtari i rastit i është përmbajtur Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. AC-I.-14-0207, me të cilin Aktgjykimi lënda ishte kthyer në rigjykim. Kolegji i Apelit e ka urdhëruar gjyqtarin e rastit në shkallë të parë që paditësit ti dërgohet një Urdhër me të cilin palës do ti kërkohej që brenda një afti të arsyeshëm kohor të specifikoi lartësinë e kërkesëpadisë, periudhën kohore për të cilën ato kërkohej si prova në mbështetje të pretendimeve të tija.

Më datë 16 janar 2023, përfaqësuesi i ankuesit ka pranuar Urdhër C-IV.-16-0404, përmes të cilit ishte kërkuar që në afat kohorë prej 15 ditëve të bëhej precizimi padis/ ankesës së parashtruar me datë 19 korrik 2013. Me Urdhër po ashtu kërkohej që të specifikoheshin saktë pretendimet lidhur me shumën e kërkuar, periudhën kohore për të cilën kërkohej kompensim si dhe te parashtrohen prova shtesë në lidhje me pretendimet e ankesës ose në të kundërtën gjykata do të hidhte poshtë ankesën si të pa pranueshme. Ankuesi po ashtu ka theksuar se brenda aftit ligjor përfaqësuesi i ankuesit i është përgjigjur Urdhrit të gjykatës ka dorëzuar përgjigje në urdhër me anë të cilit ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë ashtu siç është kërkuar në Urdhër. Mirëpo siç shihet nga Aktgjykimi i ankimuar gjykata fare nuk i ka marrë për bazë provat e ankuesit. Ankuesi përmes përgjigjes së urdhrit ka dorëzuar në Gjykatë këto prova: Librezën e punës, me anë të së cilës ka dëshmuar se ka filluar marrëdhënien e punës te e paditura me datë 02.09.1980, më shumë se 25 vite dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës i është bërës i pasojë e likuidimit të NSH-së. Kontrata e punës NR. Evid. 908 e datës 12 mars 2004 e

lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës në kohë të pa caktuar, në kontratë është e specifikuar edhe lartësia e pagës së paditësit dhe atë në shumën prej 250 euro në muaj duke filluar nga data 02.09.2002. Dhe Njoftimi për shkëputje të marrëdhënies së punës-Letër pezullimi, me datë e 27 qershorit 2006, AKM ia ka dërguar një Letër – Njoftim paditësit, me të cilën e ka njoftuar se :” si pasojë e shitjes së aseteve është përfundimi i punësimit tuaj për arsye të tepricës dhe kjo letër është njoftim zyrtar për ju se punësimi i juaj përfundon menjëherë. Shumat-pagat që u janë mbetur borxh juve, sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontakoheni kur do të fillojnë këto procedura.

Paditësi në vitin 2001 nga nana e punëdhënësit ka marrë 3 paga nga 40 euro dhe në vitin 2006 ka marrë nga 50 euro me rastin e një feste. Përderisa paga e tij sipas Kontratës ka qenë 250.00 euro. Që nga viti 2001 e deri në përfundimin e marrëdhënies së punës, paditësi ka punuar çdo ditë nga ora 7 e deri në ora 15. Evidenca e punëtorëve është mbajtur në një fletore të thjeshtë dhe ka qenë i detyruar që të punojë çdo ditë (edhe pse pa pagesë, duke shpresuar se një ditë do t ti paguhet munda) sepse në të kundërtën atij do të i ndërpritje marrëdhënia e punës.

Ankuesi e kundërshton arsyetimin se kërkesa është parashkruar ngase më 27 qershor 2006, ankuesi nga AKM-ja ka pranuar njoftimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës dhe më tutje ky njoftim përmban se “ shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontakoheni kur të fillojnë këto procedura”. Pra ankuesi ka theksuar se i është përmbajtur udhëzimeve të njoftimit të AKP-së dhe kur ka filluar procesi i likuidimit, brenda afatit të parapare ligjorë ai e ka parashtruar kërkesën e tij pra nuk mund të flitet për parashkrim.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat por jo edhe në arsyetimin ligjor.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 04 gusht 2011, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Prishtina" (në likuidim), një kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë të pa caktuar, e cila kërkesë ishte refuzuar si e pavlefshme me vendimin PRN034-0013 të datës 25 qershor 2013, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme në mbështetje të kërkesës së tij. Ai vetëm ka përfshirë një Kontratë të punës nga 1977, e cila ka qenë kontratë për punë sezonale dhe ka skaduar më 1977.

Kolegji i Apelit vëren se me 18 qershor 2014, Kolegji Specializuar i DHPGJS, me aktgjykimin C-IV-13-1331 e ka refuzuar si të pabazuara kërkesën e paditësit në mungesë të provave dhe ka vërtetuar vendimin e AL- si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Kundër këtij aktgjykimi pala paditëse kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS.

Me Aktvendimin AC-I-14-0207 të dt. 14 dhjetor 2016, Kolegji i Apelit, e kishte prishur aktgjykimin C-IV-13-1331 dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim në kolegjin përkatës.

Kolegji i Apelit po ashtu vëren se e 04 prill 2019 dhe 10 janar 2023, Shkalla e parë e DHPGJS, ashtu siç e kishte udhëzuar Kolegji i Apelit kishte kërkuar nga paditësi

që të precizoj kërkesën e tij dhe të dorëzoj prova në mbështetjeje të kërkesës se tij duke specifikuar muajt dhe vitet përkatëse si dhe shumën e kërkuar.

Me 16 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-16-0404, e ka refuzuar si e pa bazuar kërkesën e parashtruar nga paditësi dhe ka vërtetuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj vendimi e AL. Në arsyetim të aktgjykimit thuhet se pala paditëse ka pretenduar në borxh- në emër të pagave të pa paguar që i referohet periudhës kohore 2001-2006, kurse pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë me pretendimin se borxhi i pretenduar është i parashkruar. Shkalla e parë kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës ka punuar deri në vitin 2006, ndërsa kërkesën për kompensimin e pagave të pretenduar pranë Autoritetit të Likuidimit e ka parashtruar më datën 04.08.2011, që do të thotë se është parashtruar pas kalimit të aftit prej tri viteve. Andaj në kuptim të nenit 376 paragrafi i të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se "kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për demin dhe për personin që e ka bërë dëmin.

Kolegji i Apelit pajtohet me rezultatin e shkallës së I-rë por nuk pajtohet me arsyetimin e Shkallës së parë të DHPGJS, kjo për faktin se një pjesë e kërkesës për pagat e kërkuar për periudhën nga 01 janari 2001 deri me maj 2003 është parashkruar dhe se paditësi për këtë periudhë kohore nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se ka ndërprerë parashkrimin.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite.

Ndërsa kërkesa e paditësit për paga të papaguara për pjesën e periudhës nga muaji qershori 2003 deri me 27 qershor 2006 nuk është parashkuara pasi që paditësit AKM-ja i ka dërguar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 27 qershor 2006, që do të thotë se me këtë data është ndërprerë parashkrim për 3 vitet paraprake.

Megjithatë, Kolegji i Apelit konstaton se edhe pse kërkesa e paditësit nuk është parashkuar për periudhën nga muaji qershor 2003 deri në qershor 2006, paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. E paditura përveç thirrjes në parashkrim e ka kontestuar edhe mungesën e provave. Dëshmitë në të cilat thirret paditësi siç janë Libreza e punës, njoftimi mbi ndërprerjen e punësimit dhe kontrata e punës janë dëshmi me të cilët provohet se paditësi ka qen punëtor i NSH-së dhe se ai ka pasur një pagë mujore prej 250 në muaj, mirëpo këto nuk janë dëshmi me të cilat do dëshmohej se paditësit NSH ja i ka mbetur borgj pagat e paguara për periudhën nga muaji qershor 2003 deri në qershor 2006. Andaj pretendimi i paditësit se NSH-ja i ka mbetur borgj pagat e kërkuara pa mbështetje në prova janë të pa bazuara. Paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë listë të pagave të papaguara, listë bankare nga e cila do vërehej mungesa e mos pagesës së pagave të papaguar, vërtetim apo dëshmi tjera relevante me të cilët do dëshmohej se NSH i ka mbetur borgj pagate kerkuar siç ka ndodh tek shumë raste të NSH-vë.

Paditësi e ka barrën e provave siç parsh neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe neni 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar, ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 04 korrik 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 korrik 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
